

KERKESAT E VAKSINIMIT NE SHKOLLE PER FREKUENTIMIN E SHKOLLAVE NE PENSILVANI

PER FREKUENTIMIN E TE GJITHA KLASAVE, NXENESIT DUHET TE PLOTESOJNE KERKESAT NE VIJIM:



- 4 doza tetanozi, difterie, dhe kollës se mirë (1 doze në, ose pas vitit të katërt të lindjes)*
- 4 doza të poliomelitit (doza e 4ërt në ose pas vitit të katërt të lindjes, dhe sëpaku 6 muaj pas dozës së fundit)**
- 2 doza të fruthit, shytatave dhe te rubeoles. ***
- 3 doza te hepatitit B
- 2 doza te variceles (lija e dhëneve) ose provë te imunizimit
- *Zakonisht jepet si DTP ose DTaP, ose nëse këshillohet nga mjeku, DT ose Td
- **Doza e katërt nuk është e nevojshme nëse doza e tretë është dhënë ne moshën kater vjecare ose me vonë dhe është sëpaku 6 muaj pas dozës paraprake.
- ***Zakonisht jepet si MMR



NE DITEN E PARE TE SHKOLLES, përveç rasteve kur fëmija përjashtohet për arsye mjekësore, ose fetare/filozofike, fëmija duhet te ketë sëpaku 1 dozë nga vaksinat e mësipërme, ose rrezikon përjashtimin nga shkolla.

- Nëqoftëse femija nuk i ka te gjitha dozat e mesiperme, ka nevojë per doza shtese, femija do ta marrë këtë dozë ne 5 ditet e para te shkolles, ose rrezikon te përjashtohet. Nëse doza e ardhshme, nuk eshte e fundit ne serinë e vaksinimit, fëmija duhet te ketë edhe një plan mjekësor vaksinimi (karta e kuqe dhe e bardhe) brënda 5 diteve te para te shkolles, ose rrezikon te përjashtohet.
- Nëse femija nuk i ka marrë te gjitha dozat e mësipërme, ka nevojë per doza te tjera dhe doza e ardhshme nuk kërkohet menjëherë, femija duhet te ketë edhe nje plan mjekësor vaksinimi (karta e kuqe dhe e bardhë) brënda 5 diteve te para te shkolles, ose rrezikon te përjashtohet.
- Plani mjekësor duhet te ndiqet me përpikmëri, ose fëmija rrezikon te përjashtohet

PER FREKUENTIMIN E KLASES SE 7-të

- 1 doze tetanozi, difterie dhe kollës se mirë (Tdap) ne ditën e parë te klasës se 7-të
- 1 dozë te vaksinës se meningjitit (MCV) ditën e parë te klasës së 7-të

NE DITEN E PARE TE KLASES SE 7-te, përveç rasteve kur fëmija përjashtohet per arsye mjekësore, ose fetare/filozofike, fëmija duhet te ketë vaksinat e mësipërme, ose rrezikon përjashtimin.

PER FREKUENTIMIN E KLASES SE 12-të

- 1 dozë MCV ditën e parë te shkolles. Nëse 1 dozë është marrë ne moshën 16 vjec, apo me shumë, kjo do te llogaritet si dozë e kërkuar per klasën e 12-te

NE DITEN E PARE TE KLASES SE 12te, përveç rasteve kur fëmija përjashtohet për arsye mjekësore, ose fetare/filozofike, fëmija duhet të ketë kryer vaksinat e mësipërme, ose rrezikon përjashtimin.

E Këto kërkesa mund te përjashtohen per rastet ne vijim: arsye mjekësore, besimi fetar, bindje të forta etike, morale ose filozofike. Edhe nëse fëmija eshte i përjashtuar nga vaksinimet, ai ose ajo mund të largohen nga shkolla në raste epidemish që lidhen me këto vaksinime.

Kërkesat e vaksinimeve të shkollave të Pensilvanisë mund të gjenden në:
28 Pa.CODE CH.23 (School Immunization.). Kontakti qendër tuaj
mjekësore ose telefononi në 1-877-PA-HEALTH për më shumë informacion.

